



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
DREJTORIA E STUDIMEVE**

Nr. 1230/Prot.
11

Tiranë, me 13. 05. 2003

LËNDA: **Për ekspertimet që mund të kryhen në fushën e
Ndërtimit**

**PROKURORIVE
PRANË GJYKATAVE TË RRETHIT GJYQËSOR**

**PROKURORIVE
PRANË GJYKATAVE TË APELIT**

**GJITHË DREJTORIVE
KËTU**

Bashkëlidhur, Ju dërgojmë shkresën Nr. 230 datë 08. 05. 2003 të Institutit të Studimeve të Teknologjisë së Ndërtimit "Në ndihmë për zbatimin e legjislacionit në fushën e Ndërtimit" i cili ofron dhe merr përsipër ekspertime shkencore në këtë fushë.

Me këtë material të njihen prokurorët e të gjithë niveleve dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve, të të gjithë llojeve të policive.

Drejtuesit e Prokurorive të të gjitha niveleve të marrin masat e duhura ligjore dhe organizative për kryerjen e ekspertimeve në fushën e ndërtimit, duke forcuar partneritetin me këtë Institut, me synim rritjen e efektivitetit, cilësisë dhe shpejtësisë në ndjekjen penale të veprave penale në fushën e ndërtimit.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU





MINISTRIA E RREGULLIMIT TE TERITORIT DHE TURIZMIT
INSTITUTI I STUDIMEVE TE TEKNOLOGJISE SE NDERTIMIT

Nr. 130 Prot.

Tirane, me 12.05.2003

12.05.2003
130
D. H. H. H.

Lënda: Ne ndihme për zbatim legjislacioni ne fushën e Ndërtimeve

Drejtuar: Prokurorisë se Përgjithshme Tirane

Instituti i Studimeve te Teknologjisë se Ndërtimit (**ISTN**) është institucion kërkimor shkencor shtetëror, me vetëfinancim dhe me laboratorë, te akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit.


I krijuar qe nga viti 1979 dhe rinovuar me 1999, **ISTN** kryen studime, harton Rregulla Teknike, kontrollon cilësinë e materialeve te ndërtimit nëpërmjet analizave laboratorike, si dhe **ekspertiza** te ndryshme me karakter teknik.

ISTN, tashme është e licencuar "Për Mbikëqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi" ne gjithë fushën e ndërtimit (licence MK 0192), është autore e "Rregullores se Sigurimit Teknik ne Punët e Ndërtimit" si dhe e te gjitha Kushteve Teknike e Standardeve Shqiptare ne fuqi.

Për sa me sipër duke respektuar dhe vlerësuar punën Tuaj si autoritetin e përgjegjshëm ligjor te shtetit, e shohim me vend qe Prokuroria te këtë ne mbështetje te saj një Institucion Tekniko Shkencor, si **ISTN**, i cili ofron e merr përsipër me kompetence e përgjegjësi:

1. Kontrollin e cilësisë se materialeve te ndërtimit.
2. Ekspertiza te ndryshme ne objektet ndërtimore qe Ju kini ne proces gjykimi.
3. Interpretime teknike ne lidhje me shkeljet, me ose pa pasoje , ne drejtim te zbatimit te "Rregullores se Sigurimit Teknik për punimet ne Ndërtim" botim i vitit 2000.

Duke shpresuar për një bashkëpunim te gjithanshëm.

Drejtori

Dr. Zarif BERVISHI

Instituti i studimeve te Teknologjisë se Ndërtimit